



Republika e Kosovës
Republika Kosovo-Republic of Kosovo
Kuvendi - Skupština - Assembly

Legjislatura IV
Sesioni pranveror

Mbledhja plenare e Kuvendit
P- 14
Prishtinë, më 19 maj 2011

P R O C E S V E R B A L

**I MBLEDHJES PLENARE TË KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË KOSOVËS, TË
MBAJTUR MË 19 MAJ 2011**

Mbledhjen e kryesoi **Jakup KRASNIQI**, Kryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar Kuvendit.

Kryetari deklaroi të hapur punimet e mbledhjes plenare dhe konstatoi se në sallë janë të pranishëm 70 deputetë. Ai i njoftoi deputetët se Kryesia e Kuvendit, në marrëveshje me përfaqësuesit e grupeve parlamentare, ka përgatitur dhe Kuvendit ia ka paraqitur rendin e ditës për mbledhjen e sotme plenare.

Kuvendi i zhvilloi punimet me këtë:

R e n d i t e

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës,
2. Koha për pyetje parlamentare,
3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mëparshme,
4. Shqyrtimi i Raportit financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010,
5. Debat parlamentar lidhur me masakrën në burgun e Dubravës, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, me mbështetje të grupit të deputetëve nënshkrues,
6. Miratimi i Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit,
7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Media për formimin e Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media,

8. Shqyrtimi i Propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e Organit Përzgjedhës të Pavarur, për zgjedhjen e anëtarit në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik,
9. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për ujëra dhe mbeturina, për vitin 2010,
10. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, për vitin 2010,
11. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010,
12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Energji, për vitin 2010,
13. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2010,
14. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2010,
15. Shqyrtimi i Raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010,
16. Debat parlamentar lidhur me bashkëpunimin e Republikës së Kosovës me Interpolin dhe Europolin, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Lladrovci, të mbështetur edhe nga deputetë të tjerë.

1. Koha për deklarime jashtë rendit të ditës

Deklarime jashtë rendit të ditës paraqitën deputetët: Armend Zemaj, Hydajet Hyseni, Visar Ymeri, Donika Kadaj-Bujupi, Bekim Haxhiu, Sali Asllanaj, Glauk Konjufca, Afërdita Berisha-Shaqiri, Alma Lama dhe kryeministri Hashim Thaçi, që janë dhënë në transkript.

2. Koha për pyetje parlamentare

Deputetja Teuta Haxhiu, e lexoi pyetjen për Zv. kryeministrin, Behxhet Pacolli. Zv.Kryeministri Pacolli nuk ishte prezent në mbledhje.

Deputetja Salihe Mustafa, parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani lidhur me asgjësimin e barnave me afat të skaduar.

Ministri Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Mustafa.

Deputetja Time Kadrijaj, parashtoi pyetje për ministrin Ferid Agani lidhur me lejimin e ndërtimit të spitaleve private në pronën e QKUK-së.

Ministri Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Kadrijaj.

Deputeti Arsim Bajrami, parashtoi pyetje për ministrin Mahir Yagcilar lidhur me implementimin e procesit të qeverisjes elektronike.

Ministri Yagcilar iu përgjigj pyetjes së deputetit Bajrami.

Deputeti Arsim Bajrami, parashtoi pyetje për ministren Vlora Çitaku lidhur me adresimin e vërejtjeve dhe rekomandimeve të shpalosura në raportin e progresit të vitit 2010.

Ministrja Çitaku iu përgjigj pyetjes së deputetit Bajrami.

Deputetja Rita Hajzeraj-Beqaj, parashtroi pyetje për ministrin Ferid Agani lidhur me kohën e procedimit të Projektligjit për Sigurimin Shëndetësor, në Kuvend.

Ministri Agani iu përgjigj pyetjes së deputetes Hajzeraj-Beqaj.

3. Miratimi i Procesverbalit të mbledhjes plenare të mbajtur me 6 maj 2011

Kuvendi miratoi procesverbalin e mbledhjes plenare të datës 6 maj 2011, pa vërejtje.

4. Shqyrtimi i Raportit financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010

Ministri **Bedri Hamza**, në emër të Qeverisë së Republikës së Kosovës, paraqit dhe arsyetoi Raportin financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010. Ai në vazhdim tha se Raporti të cilin po e shqyrtojmë sot është i bazuar në Ligjin për menaxhimin e financave publike dhe përgjegjësitë. Në vazhdim, tha se e veçanta e këtij Raporti qëndron në prezantimin e performancës së mirë të institucioneve të Republikës së Kosovës në fushën e menaxhimit të parasë së taksapaguesve të vendit, ndërsa si veçori tjera përmendi: rritjen e të hyrave, tejkalimin e planit të të hyrave për disa kategori, rritjen në kategorinë e investimeve kapitale, etj.

Më tutje, ministri Hamza konstatoi se plani vjetor i të hyrave ka qenë mbi 1 miliard e 230 milionë €, ndërsa plani vjetor i pagesave ka qenë mbi 1 miliard e 348 milionë €, Më tej, ai u fokusua në elaborimin e të dhënave statistikore për të gjitha kategoritë, veç e veç, të cilat lidhen me këtë raport.

Ministri Hamza potencoi më poshtë se nga Buxheti i Republikës së Kosovës janë bërë edhe disa pagesa të tjera, siç janë: pagesa për anëtarësimin e Republikës së Kosovës në institucionet financiare ndërkombëtare, në shumën prej mbi 168 mijë €, pagesa në emër të borxhit të Republikës së Kosovës në Bankën Botërore, në shumën mbi 10 milionë € .

Në fund, ministri Hamza ftoi deputetët e Kuvendit që ta miratojnë këtë raport.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Komisionit për Buxhet dhe Financa, Naser Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Hasime Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Hikmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Muhamet Mustafa, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jelena Biontiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 50,
Kundër----- 28,
Abstenime----- 1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Raporti financiar për Buxhetin e Republikës së Kosovës, për vitin 2010.
2. Ministria e Financave, në raportet e ardhshme vjetore të prezantojë në përqindje strukturën dhe dinamikën e realizimit të të hyrave dhe shpenzimeve buxhetore.
5. **Debat parlamentar lidhur me masakrën në burgun e Dubravës, sipas kërkesës së deputetit Nait Hasani, me mbështetje të grupit të deputetëve nënshkrues**

Kryesuesi, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, tha se deputeti Nait Hasani dhe grupi i deputetëve nënshkrues, ka parashtruar në Kuvend kërkesën për debat parlamentar lidhur me masakrën në burgun e Dubravës, e cila ka ndodhur nga 19-25 maj 1999, gjatë luftës në Kosovë.

Kryesuesi ftoi deputetin Nait Hasani për prezantimin dhe arsyetimin e kërkesës për debat.

Deputeti **Nait Hasani** tha se përmes këtij debati të kërkuar synojmë të trajtojmë një nga masakrat më të tmerrshme që ka ndodhur më 19-24 maj 1999, në burgun e Dubravës, nga gardianët, policët dhe ushtarët serbë ndaj të burgosurve shqiptarë.

Deputeti Hasani, në vazhdim tha se masakra në burgun e Dubravës ka qenë e përgatitur, e planifikuar dhe e kryer që nga udhëheqja qendrore e Serbisë e deri te gardianët e burgut të Dubravës. Se kjo është e vërteta, këtë e dëshmon grumbullimi i të burgosurve shqiptarë në burgun e Dubravës nga shumë burgje të tjera në Serbi dhe në Kosovë, siç ka ndodhur me të burgosurit shqiptarë: nga burgu i Nishit, nga burgu i Mitrovicës së Sremit, ku iniciuesin e këtij debati bashkë me 63 të burgosur shqiptarë i vendosin në burgun e Dubravës, pastaj nga burgu i Prizrenit, nga burgu i Gjilanit, nga burgu i Pejës, dhe shumë shqiptarë tjerë të zënë robër nga Gjakova, Suhareka dhe vise të tjera të Kosovës.

Më tutje, ai grumbullimin e të burgosurve shqiptarë në Burgun e Dubravës e vlerësoi si mish për top, sepse Serbia kishte vendosur sistemin e radarëve ushtarakë dhe pistën e avionëve në hapësirën e burgut të Dubravës.

Masakrën në burgun e Dubravës nuk ka mundësi ta imagjinojnë as skenarët e filmave horror të Hiçkokut, kjo ngase duhet të vriteshin dhe masakroheshin sa më shumë që është e mundur të burgosurit shqiptarë dhe për këtë kinse fajtorë të mbetej NATO-ja, tha ai.

Deputeti Hasani potencoi se ky debat dhe kallëzimi penal që është bërë në Prokurorinë e Pejës, më 19 janar 2007, ka për qëllim të nxjerrë në shesh masakrën e tmerrshme të ndodhur gjatë luftës në Kosovë, në fund shekullin XX, e cila as që mund të krahasohet me krimet e nazi-fashizmit në Luftën e Dytë Botërore, e as me Mathuazenin e Aushvicit. Në masakrën e Burgut të Dubravës u vranë mbi 130 të burgosur dhe u plagosën mbi 300 të burgosur të tjerë, theksoi deputeti Hasani.

Më tutje, ai përmendi edhe shumë raste të rrëmbimit të veprimtarëve, humanistëve, mjekëve nga policia sekrete serbe, dhe fatin e tyre si të zhdukur, siç janë Hafir Shala, Xhavit Haziri, Ukshin Hoti, etj. Për Ukshin Hotin tha se të gjithë të mbijetuarit e masakrës në burgun e Dubravës e dinë se Ukshin Hotin e ka marrë nga dhoma e burgut të Dubravës, gardiani Branko Komatina, të gjithë e dinë se në këtë burg ka qenë përgjegjës drejtori Aleksandar Rakoqeviq-Aca, i cili ka qenë drejtor në Burgun Qendror të Beogradit, pas luftës, të gjithë e dinë se komandant burgu ka qenë Miodrag Vidiq –Miki,

që të gjithë këta persona që i përmenda, e dinë se ku është dhe cili është apo ka qenë fati i Ukshin Hotit, pas daljes nga burgu, më 16 maj 1999.

Në fund, deputeti Hasani kërkoi nga institucionet e vendit që të përdorin çdo mundësi që kriminelët të dalin para drejtësisë, të ngrihet aktakuzë me qëllim të gjyqimit të kriminelëve të masakrës në Burgut të Dubravës dhe shumë masakrave tjera që kanë ndodhur gjatë luftës në Kosovë. Ai kërkoi nga zv. kryeministrja Edita Tahiri, që në bisedimet me Serbinë të kërkojë të sillen para drejtësisë në Pejë dhe të dënohen kriminelët që bënë masakrën në burgun e Dubravës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Elmi Reçica, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ismet Beqiri, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ahmet Isufi, në emër të Grupit Parlamentar Kosova e Re, Ibrahim Makolli, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, në emër të Qeverisë së Kosovës, zv. kryeministri Hajredin Kuçi si dhe deputetët: Albin Kurti, Fatmir Limaj, Afërdita Berisha-Shaqiri, kryetari Jakup Krasniqi, Sabri Hamiti, Time Kadrijaj, Xhevahire Izmaqi, Sevdije Lama, Vjosa Osmani, Afrim Kasolli, Flora Brovina, Burim Ramadani, Kurtan Kajtazi, Ilmi Reçica, Lumnije Morina, Halit Krasniqi, Suzana Novoberdaliu, Hashim Deshishku, Fadil Demaku, Gëzim Kelmendi, Salihe Mustafa, Ramiz Lladrovci, Behar Selimi dhe Bekim Haxhiu, që janë dhënë në transkript.

Deputeti **Nait Hasani**, në fund të diskutimeve falënderoi deputetët për diskutimet e zhvilluara në Kuvend për këtë pikë të rendit të ditës, propozoi rekomandimin dhe i ftoi deputetët për miratim të atij rekomandimi.

Kryesuesi hodhi në votim Rekomandimin e propozuar nga deputeti Nait Hasani.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 61,
Kundër----- 4,
Abstenime----- 0.

Kryetari konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash,

V E N D O S I

Kuvendi i Republikës së Kosovës kërkon nga organet e gjyqësisë së Kosovës që të përshpejtojnë veprimet ligjore, duke ndërmarrë veprime të hetimeve ndaj atyre kryerësve të krimeve dhe të ngritin aktakuzë, me qëllim të gjyqimit të kriminelëve të luftës me rastin e masakrës në burgun e Dubravës nga 19 – 25 maj 1999.

6. Miratimi i Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit

Kryesuesi, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se Komisioni për Legjislacion, në pajtim me Rregulloren e Kuvendit ka hartuar Rregulloren për zgjedhjen

dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe të zëvendësve të Avokatit të Popullit, dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime, për shqyrtim dhe miratim në mbledhje plenare.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Armend Zemaj, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Ibrahim Makolli, si dhe deputetët Alma Lama dhe Bekim Haxhiu, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Rregullores për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 57,

Kundër----- 0,

Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Rregulloren për zgjedhjen dhe shkarkimin e Avokatit të Popullit dhe zëvendësve të Avokatit të Popullit.

7. Shqyrtimi i Rekomandimit të Komisionit për Media për formimin e Komisionit Ad Hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media

Kryesuesi, në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës tha se Komisioni për Arsim, Kulturë, Rini, Sport, Administratë Publike, Qeverisje Lokale dhe Media ka shqyrtuar listën e propozuar nga Komisioni i Pavarur për Media për emërimin e anëtarëve të Këshillit të Komisionit të Pavarur për Media, dhe Kuvendit i ka paraqitur Raportin me rekomandime.

Ai, në vazhdim, duke u bazuar në nenin 4.4 pika e) të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetimin, kërkoi nga partitë politike të përfaqësuara në Kuvend që të paraqesin emrin e përfaqësuesit të saj në Komisionin Ad Hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media.

Meqenëse shumica e partive politike të përfaqësuara në Kuvend nuk ishin të gatshme të paraqesin propozimet e veta për komisionin e lartpërmendur, Kryesuesi propozoi që në ndërkohë ato t’i bëjnë propozimet e veta.

Kryesuesi, në fund të kësaj pike konstatoi se Kuvendi nxori këtë:

P Ë R F U N D I M

Kërkohet nga partitë politike, të përfaqësuara në Kuvend, që përmes administratës së Kuvendit ta propozojnë nga një (1) anëtar në Komisionin Ad Hoc për përzgjedhjen e anëtarëve të Komisionit të Pavarur për Media, i cili do të veprojë në përputhje me nenin 4 të Ligjit për Komisionin e Pavarur për Media dhe Transmetim.

8. Shqyrtimi i Propozimit të Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e Organit Përzgjedhës të Pavarur, për zgjedhjen e anëtarit në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Këshilli Gjyqësor i Kosovës, në pajtim me dispozitat e Ligjit për Përbërjen e Përkohshme të Këshillit Gjyqësor të Kosovës, ka propozuar tre (3) gjykatës të cilët do ta përbëjnë Organin Përzgjedhës të Pavarur për emërimin e anëtarit në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Ai, në vazhdim tha se për këtë çështje mund të deklarohen kryetarët ose përfaqësuesit e grupeve parlamentare.

Asnjë nga grupet parlamentare nuk u deklaruan lidhur me këtë çështje.

Kryesuesi hodhi në votim miratimin e Këshillit Gjyqësor të Kosovës për emërimin e Organit Përzgjedhës të Pavarur, për zgjedhjen e anëtarit në Organin Shqyrtues të Prokurimit Publik.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 9.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë:

V E N D I M

I. Anëtarë të Organit Përzgjedhës të Pavarur, emërohen:

1. Shukri Sylejmani, gjyqtar, Gjykata Supreme e Kosovës,
2. Nehat Idrizi, gjyqtar, Gjykata e Qarkut në Prishtinë,
3. Rasim Rasimi, gjyqtar, Gjykata e Qarkut në Gjiilan.

9. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Rregullatorit për ujëra dhe mbeturina, për vitin 2010

Deputeti **Nait Hasani**, në emër të Komisionit funksional për Bujqësi, Pylltari, Mjedis dhe Planifikim Hapësinor, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Rregullatorit për ujëra dhe mbeturina, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Ai, në fund përkrahu Raportin vjetor të Rregullatorit për ujëra dhe mbeturina, për vitin 2010.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të Rregullatorit për ujëra dhe mbeturina për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë Raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Nijazi Idrizi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ali Sadriu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes “Vetëvendosje”, Liburn Aliu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Time Kadrijaj, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Helili, ndërsa në

emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, si dhe deputetja Teuta Haxhiu, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Rregullatorit për ujëra dhe mbeturina, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 67,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin vjetor të Rregullatorit për ujëra dhe mbeturina, për vitin 2010.

Kryesuesi, në vazhdim, lidhur me pikën nr. 10 të rendit të ditës propozoi që kjo pikë të shqyrtohet më vonë, gjatë kësaj mbledhje plenare, për shkak të mungesës së dy kryetarëve të komisioneve raportuese.

Kuvendi miratoi propozimin e kryesuesit.

11. Shqyrtimi i Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010

Deputeti **Ali Sadriu**, në emër të Komisionit funksional për Mbikëqyrjen e Financave Publike, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin e auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare, bashkë me rekomandimet e komisionit që ai udhëheq.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Valbona Dibra, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Ali Sadriu, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Alma Lama, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Bali Muharremaj, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Ibrahim Makolli, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të auditimit të pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin e përfunduar më 31 dhjetor 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 51,
Kundër----- 11,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, mori këtë

V E N D I M

1. Miratohet Raporti me rekomandime i Zyrës së Auditorit të Përgjithshëm lidhur me auditivin e pasqyrave financiare të Komisionit të Pavarur për Media, për vitin përfundimtar më 31 dhjetor 2010.
2. Obligohet Komisioni i Pavarur për Media që, në afatin brenda gjashtëdhjetë (60) ditësh, nga dita e miratimit të këtij Raporti, përmes Komisionit për Mbikëqyrjen e Financave Publike, ta njoftojë Kuvendin e Kosovës për veprimet e ndërmarra në përmbushjen e rekomandimeve të ZAP-it.
3. Kuvendi i Kosovës të ndërmarrë veprimet e nevojshme për kompletimin e Këshillit të Pavarur për Media.

Në vazhdim të mbledhjes plenare, deputetja **Sala Berisha-Shala** propozoi që shqyrtimi i pikave tjera të rendit të ditës të vazhdojë për ditën e nesërme, më 20 maj 2011.

Kryesuesi kërkoi nga Kuvendi të deklarohet për propozimin e deputetes Sala Berisha-Shala.

Kuvendi miratoi propozimin për ndërprerjen e punimeve të mbledhjes së sotme për t'i vazhduar nesër, më 20 maj 2011, në orën 10:00.

Kryesuesi e përfundoi mbledhjen e sotme në orën 17:50 minuta.

E premte, 20 maj 2011,

Vazhdimi i mbledhjes plenare të filluar më 19 maj 2011

Mbledhjen e kryesoi **Xhavit HALITI**, nënkryetar Kuvendit, kurse i ndihmoi **Sabri HAMITI**, nënkryetar Kuvendit.

Kryesuesi deklaroi të hapur vazhdimin e punimeve të mbledhjes plenare, të filluar më 19 maj 2011. Ai tha se në radhë për shqyrtim është pika nr. 10 e rendit të ditës.

10. Shqyrtimi i Raportit të punës së Agjencisë kundër Korrupsionit, për vitin 2010

Kryesuesi njoftoi Kuvendin se Komisioni funksional për Legjislacion, ka shqyrtuar Raportin e punës të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit, për vitin 2010 dhe Kuvendit i ka rekomanduar për miratim. Ai tha se edhe Komisioni për Buxhet dhe Financa, ka shqyrtuar Raportin e punës të Agjencisë Kosovare Kundër Korrupsionit për vitin 2010 dhe Kuvendit ia ka rekomanduar për miratim.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Agjencisë kundër korrupsionit, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Halit Krasniqi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së,

Hikmete Bajrami, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Suzana Novoberdaliu, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar SLS, Mursel Halili, si dhe deputeti, Ardian Gjini, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	68,
Kundër-----	3,
Abstenime-----	3.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e punës së Agjencisë Kundër Korrupsionit, për vitin 2010.

12. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Rregullatorit për Energji, për vitin 2010

Deputetja **Teuta Sahatqija**, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Rregullatorit për Energji, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të Rregullatorit për Energji, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Berat Buzhala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Teuta Sahatqija, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Visar Ymeri, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Donika Kadaj-Bujupi, ndërsa në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Albert Kinolli, dhe deputeti Berat Buzhala, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Rregullatorit për Energji, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	78,
Kundër-----	1,
Abstenime-----	2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin vjetor të Rregullatorit për Energji, për vitin 2010.

13. Shqyrtimi i Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2010

Deputetja **Teuta Sahatqija**, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të

Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Agim Kuleta, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Fikrim Damka, dhe deputetja Teuta Sahatqija dhe ministri Fehmi Mujota, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2010.

Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	63,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	1.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportit vjetor të Autoritetit të Aviacionit Civil, për vitin 2010.

14. Shqyrtimi i Raportit vjetor i Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2010

Deputetja **Teuta Sahatqija**, në emër të Komisionit funksional për Zhvillim Ekonomik, Infrastrukturë, Tregti dhe Industri, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Sala Berisha-Shala, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Lutfi Zharku, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Afrim Hoti, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Burim Ramadani, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Myzejene Selmani, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Biserka Kostiq, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Fikrim Damka, dhe deputeti Kurtan Kajtazi, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2010. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për-----	53,
Kundër-----	0,
Abstenime-----	7.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportit vjetor të Autoritetit Rregullativ të Hekurudhave, për vitin 2010.

15. Shqyrtimi i Raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010

Deputeti **Behar Selimi**, në emër të Komisionit funksional për Legjislacion, tha se si komision kemi shqyrtuar Raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010, dhe kemi rekomanduar shqyrtimin dhe miratimin në mbledhje plenare.

Kryesuesi hapi debatin për shqyrtimin e Raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë raport dhanë: në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, Behar Selimi, në emër të Grupit Parlamentar të LDK-së, Vjosa Osmani, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, Albulena Haxhiu, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, Ardian Gjini, në emër të Koalicionit Kosova e Re, Suzan Novoberdaliu, në emër të Grupit Parlamentar SLS, Jasmina Zhivkoviç, ndërsa në emër të Grupit Parlamentar “6+”, Duda Balje, që janë dhënë në transkript.

Pas këtyre diskutimeve, kryesuesi hodhi në votim miratimin e Raportit të punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010. Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 64,
Kundër----- 0,
Abstenime----- 2.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, miratoi Raportin e punës së Institutit Gjyqësor të Kosovës, për vitin 2010.

16. Debat parlamentar lidhur me bashkëpunimin e Republikës së Kosovës me Interpolin dhe Europolin, sipas kërkesës së deputetit Ramiz Lladrovci, të mbështetur edhe nga deputetë të tjerë

Kryesuesi në fillim të shqyrtimit të kësaj pike të rendit të ditës, tha se deputeti Ramiz Lladrovci dhe grupi i deputetëve nënshkrues, ka parashtruar në Kuvend, kërkesën për debat parlamentar lidhur me bashkëpunimin e Republikës së Kosovës me Interpolin dhe Europolin.

Kryesuesi ftoi deputetin Ramiz Lladrovci, për prezantimin dhe arsyetimin e kërkesës për debat.

Deputeti **Ramiz Lladrovci** tha se në Kosovë ekziston Zyra ndërlidhëse e Europolit, e cila udhëhiqet nga UNMIK-u, në kuadër të së cilës bëjnë pjesë zyrtarë të policisë së EULEX-it dhe të Policisë së Kosovës.

Deputeti Lladrovci, në vazhdim theksoi se qëllimi i këtij debati është nxitja e institucioneve të Kosovës për anëtarësim në Interpol dhe Europol, sa më shpejt që është e mundur.

Më tutje ai foli për një historik të shkurtër të themelimit të këtyre dy organizatave ndërkombëtare, në të cilat pretendon të anëtarësohet Republika e Kosovës, për të

konstatuar më pas se shteti i Kosovës, tashmë është i aftë t'i bartë përgjegjësitë e sigurisë dhe bashkëpunimit nga kjo fushë, sipas standardeve ndërkombëtare.

Ai kërkesën e Republikës së Kosovës për anëtarësim në këto dy organizata ndërkombëtare e vlerësoi si çështje e cila duhet të bëhet sa më parë.

Serbia ka manipuluar me këto dy organizata duke shpikur dhe duke ngritur fletëarreste të pabazuara për qytetarët e Kosovës dhe zyrtarë më të lartë shtetëror, për çka jemi dëshmitarë të rasteve të shumta të cilat kanë ndodhur në të kaluarën. Ai më tej shtroi nevojën e sqarimit të statusit final të këtyre fletëarresteve të ngritura nga Serbia, të cilat janë në fakt dosje politike që kanë për qëllim denigrimin e luftës çlirimtare të popullit të Kosovës.

Në vijim deputeti Lladrovci konstatoi se, sikur Policia e Kosovës të ketë qasje në këto organizata, do të ndërpriteshin mundësitë e shantazhimit me raste të tilla, si dhe do të mbrohej dinjiteti i të gjithë qytetarëve të vendit, por njëkohësisht do të kontribuonte në rritjen e stabilitetit dhe çështjeve të sigurisë në rajon dhe më gjerë.

Në fund, ai u fokusua në marrëveshjet bilaterale që ka nënshkruar Republika e Kosovës, me vende të ndryshme, nga kjo fushë, të cilat janë një argument shtesë, në funksion të anëtarësimit sa më të shpejtë të mundshëm të vendit tonë, në Interpol dhe Europol.

Deputeti **Ahmet Isufi**, në emër të Komisionit funksional për Punë të Brendshme, Siguri dhe Mbikëqyrjen e FSK-së, përkrahu kërkesën e deputetit Ramiz Lladrovci, dhe shtroi nevojën imediate të kërkesës për inkuadrim të Republikës së Kosovës në këto dy organizata.

Deputeti **Behar Selimi**, në emër të Grupit Parlamentar të PDK-së, pasi përkrahu kërkesën për inkuadrim të Republikës së Kosovës në këto dy organizata, u fokusua në afatet që Ministria e Punëve të Brendshme të raportojë në Kuvend, lidhur me proceduarat, pengesat dhe rezultatet që do të shfaqen në këtë drejtim.

Deputeti **Rexhep Selimi**, në emër të Grupit Parlamentar të Lëvizjes Vetëvendosje, pasi përkrahu kërkesën për inkuadrim të Republikës së Kosovës në këto dy organizata, shfaqti bindjen se ngecjet tona në këtë drejtim janë pasojë edhe e mosaktiviteteve të duhura të institucioneve vendore. Ai më tej këtë gjendje e ilustroi edhe me procesin e bisedimeve të tanishme, që Kosova ia ka mundësuar shtetit të Serbisë.

Deputeti **Burim Ramadani**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, pasi përkrahu kërkesën e deputetit Ramiz Lladrovci, tha se fletëarrestet e Serbisë për qytetarët e Kosovës, nuk kanë hasur në reagim konkret nga institucionet e vendit, ndërsa EULEX-i nuk duhet të marrë në pronësi çështjet që lidhen me këtë fushë dhe se kjo pronësi duhet t'u takojë institucioneve të Republikës së Kosovës.

Deputetja **Suzana Novoberdaliu**, në emër të Grupit Parlamentar të AAK-së, pasi përkrahu kërkesën e deputetit Lladrovci, theksoi se këto fletëarreste që ka shpikur Serbia, e dëmtojnë rëndë edhe vet Interpol-in, çështje këto të cila duhet të trajtohet me kompetencë nga vetë këto organizata.

Ajo më tutje propozoi rekomandime për institucionet gjegjëse të vendit, lidhur me këtë çështje.

Deputeti **Rasim Demiri**, në emër të Grupit Parlamentar "6+" pasi përkrahu kërkesën e deputetit Lladrovci, theksoi rëndësinë që ka kjo çështje për Republikën e Kosovës.

Opinione, vërejtje dhe sugjerime lidhur me këtë pikë të rendit të ditës dhanë deputetët: Sabri Hamiti, Blerta Deliu, Glauk Konjufca, Fadil Demaku, Shaip Muja, Valbona Dibra, Afrim Hoti, Fatmir Xhelili, Zenun Pajaziti, Arsim Bajrami, Sala Berisha-Shala dhe ministri Bajram Rexhepi, që janë dhënë në transkript.

Në fund të debatit, deputeti **Ramiz Lladrovci**, në emër të propozuesit të mocionit, falënderoi deputetët për kontributin e dhënë lidhur me këtë debat. Ai i propozoi Kuvendit që t'i miratojë rekomandimet nga ky debat.

Kryesuesi hodhi në votim rekomandimet e propozuara nga deputeti Lladrovci.
Rezultati i votimit ishte, si vijon:

Për----- 60,
Kundër----- 1,
Abstenime----- 4.

Kryesuesi konstatoi se Kuvendi, me shumicë votash, nxori këto:

R E K O M A N D I M E

1. Qeveria e Republikës së Kosovës, sa më parë, ta plotësojë dokumentacionin e duhur dhe t'ia dërgojë Sekretarit të Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it, për anëtarësim në këtë organizatë të sigurisë, sipas procedurave të saj.
2. Qeveria e Republikës së Kosovës të kërkojë nga sekretari i Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it, me seli në Lion, që Zyra Ndërlidhëse e saj në Kosovë, t'i kalojë në shërbim të plotë Policisë së Kosovës, ndërsa përfaqësuesit e UNMIK-ut në këtë Zyrë të kalojnë në cilësinë e këshilltarëve të Policisë së Kosovës, deri në pranimin e saj zyrtar.
3. Qeveria e Republikës së Kosovës t'i kërkojë sekretarit të Asamblesë së Përgjithshme të INTERPOL-it që Policia e Kosovës të ketë qasje në linkun e INTERPOL-it, dhe ta shtrijë atë në të gjitha pikat kufitare.
4. Qeveria e Republikës së Kosovës të bëjë marrëveshje bashkëpunimi policor me shtetet anëtare të EUROPOL-it dhe INTERPOL-it, veç e veç, sidomos me ato shtete, që e kanë njohur pavarësinë e Kosovës, dhe të shkëmbejnë informacione përmes tyre me EUROPOL-in dhe INTERPOL-in.

Kryesuesi e deklaroi të mbyllur seancën në orën 13 : 25 minuta.

Kryetari i Kuvendit

Jakup KRASNIQI

Përgatiti: Divizioni për Çështje Plenare dhe Procedurale